



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 52 regjistër (JR)
Datë 22.10.2019

Nr. 20 i vendimit
Datë 14.07.2021

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Ardian Hajdari	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 14.07.2021, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 52 (JR), datë 22.10.2019, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrnjaj), me detyrë gjyqtare/kryetare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 175, datë 04.07.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrnjaj).

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pikat 2, 3, 5 e 10 të Kushtetutës, nenet A, Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, nenet 62, 63 e vijues, si dhe neni 66, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrnjaj), të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet e dorëzuara në Kolegji, e cila kërkoi përfundimisht prishjen e vendimit

nr. 175, datë 04.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrraj), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtares dhe njëkohësisht kryetares pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Shkodër, për rrjedhojë ajo gëzon statusin e magjstrates¹. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, znj. Valbona Seknaj (Durrraj) iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor², në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë³, deklaratën për kontrollin e figurës⁴ dhe formularin e vetëvlerësimit profesional⁵.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishtëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - (iii) *Ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Ka kryer deklaram të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja dërgoi një raport të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.
5. Inspektorati pranë KLD-së ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi

¹ Neni 2, pika “gj” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se magjistrat është edhe gjyqtari (kryetarët e gjykatës), ndërkohë neni 164, pika 2 e të njëjtit ligj parashikon se gjyqtarët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar sipas të njëjtit ligj, vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit.

² Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

³ Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 26.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 26.01.2017. Të njëjtën datë mban edhe deklarata e pasurisë në rubrikën përkatëse.

⁴ Referuar përcaktimit në raportin e DSIK-së nr. ***, datë 02.11.2017.

⁵ Referuar raportit nr. {***} prot., datë 31.07.2018, të Inspektoratit pranë KLD-së për “Analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Valbona Durrraj për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016”, formulari i vetëvlerësimit profesional është dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pranë KLD-së, më datë 26.01.2017.

objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm⁶ dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Inspektorati pranë KLD-së, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrnj), bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke marrë vendimin nr. 175, datë 04.07.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 175, datë 04.07.2019, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrnj), me detyrë gjyqtare/kryetare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

8.1. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrnj): (i) ka deklarim të pasaktë të pasurive dhe të interesave privatë, si dhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, të parashikuara në nenin D, të Aneksit të Kushtetutës; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve; (iii) ka fiktivitet në lidhje me dy kontratat noteriale për shitjen e një pasurie, me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore (evazion fiskal), për shkak të dorëzimit në ZVRPP të kontratës me vlerë më të ulët se vlera e shitjes së pasurisë; (iv) ka deklarim të rremë në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti privat i avokatisë dhe nga aktiviteti privat i bashkëshortit; (v) ka ndërtim të paligjshëm në vitin 2013 të godinës 2-katëshe në {***}, si dhe ka mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar ndërtimin dhe mobilimin e kësaj godine; (vi) ka deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

9. Subjekti i rivlerësimit iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar “Kolegji”) me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 175, datë 04.07.2019, me pretendimin se procesi i kryer në Komision dhe vendimi i dhënë vetëm për një kriter rivlerësimi (kriterin e vlerësimit të pasurisë) është rezultat i një hetimi administrativ të njëanshëm, të paracaktuar, i realizuar në kundërshtim të plotë me normat kushtetuese, ato procedurale dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Subjekti pretendoi se moszbatimi dhe mosrespektimi i parimeve të procesit të rregullt, në kundërshtim me parashikimet e nenit 179/b, pika 2 e Kushtetutës, ka sjellë si pasojë marrjen e një vendimi të padrejtë, të pambështetur në ligj dhe në prova dhe në cenim të hapur të standardeve kushtetuese, lidhur me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
10. Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrnj), bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:

⁶ Dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 31.07.2018.

- *Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 175 vendimi, datë 04.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrraj).*
- *Vazhdimin e hetimit administrativ për tre komponentët e procesit të rivlerësimit që lidhen me pasurinë, figurën dhe aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj Durrraj;*
- *Ndryshimin e vendimit nr. 175, datë 04.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrraj), me detyrë gjyqtare/kryetare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.*

11. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale, si dhe ato të zbatimit të ligjit material, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

11.1. *Procesi i rivlerësimit në Komision, i zhvilluar vetëm për kriterin e pasurisë, është rrjedhojë e kuptimit dhe zbatimit të gabuar të dispozitave kushtetuese dhe atyre ligjore që normojnë procesin e rivlerësimit, pasi ai duhet të përfshijë hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit dhe vendimmarrja të jetë rrjedhojë e një vlerësimi tërësor për të tria kriteret. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj Durrraj, pretendoi se procesi i rivlerësimit i kryer në Komision në rastin e saj ka qenë paragjykses, diskriminues dhe ka cenuar parimin e barazisë para ligjit, si pasojë e faktit se në raste të tjera hetimi administrativ është shtrirë në të tria kriteret e rivlerësimit, ndonëse vendimi mund të jetë marrë vetëm mbi bazën e njërit prej kriterëve.*

11.2. *Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, konkluzioni i arritur prej tij, për deklarim të pamjaftueshëm sipas dispozitës së sipërcituar, është i gabuar dhe i pabazuar në ligj, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon domosdoshmërisht vlerësimin edhe për kriterin e figurës, përveç atij të pasurisë, ndërkohë që Komisioni ka kryer vetëm vlerësimin e kriterit të pasurisë.*

11.3. *Komisioni ka shkelur parimin për proces të rregullt ligjor, duke paragjykuar çështjen dhe duke paracaktuar vendimin, pasi i njëjti Komision që ka bërë hetimin administrativ, mbledhjen e provave dhe ngritjen e dyshimeve, ka dhënë edhe vendimin përfundimtar në rolin e gjyqtarit, në konflikt të hapur interesi, në kundërshtim me parimin për një gjykim të drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe të pandikuar nga faktorë të tjerë.*

12. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

12.1. *Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrraj), kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me mosplotësimin e deklaratës së pasurisë vetting në përputhje me ligjin dhe pretendoi se deklaratimet e dhëna prej saj janë të plota, të vërteta dhe të mbështetura në prova.*

- *Lidhur me pasurinë e paluajtshme “apartament banimi” me sipërfaqe 115,3 m², në adresën rr. “{***}”, shk. {***}, k. {***}, ap. {***}, Tiranë:*

12.2. *Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2004-2010, e cila ka rezultuar me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për krijimin e pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament banimi” në vlerën prej 3.997.962 lekë.*

12.3. *Konkluzioni i Komisionit për fiktivitet të kontratave noteriale për shitjen e pasurisë së paluajtshme me sip. 66 m² në Shkodër, me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore (evazion fiskal), është i gabuar pasi nuk ndodhemi në kushtet e kontratave fiktive dhe as të shmangies së detyrimeve tatimore lidhur me të ardhurat e krijuara nga shitja e kësaj pasurie.*

◦ Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “dyqan” me sip. 46 m² në Shkodër, blerë në vitin 1997 dhe pjesën e pandarë të dyqanit me sip. 10 m², blerë në vitin 2006:

12.4. Subjekti pretendoi se konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së dyqanit me sip. 46 m² në vitin 1997 është i gabuar, pasi nuk është llogaritur në mënyrë të saktë niveli i të ardhurave të subjektit dhe të bashkëshortit të saj, për periudhën 1989-1997. Subjekti i rivlerësimit ngre të njëjtin pretendim për konkluzion të gabuar të Komisionit, mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme edhe lidhur me blerjen në vitin 2006, të sipërfaqes prej 10 m², pjesë e pandarë e dyqanit të blerë në vitin 1997, si pasojë e mospërfshirjes së një pjese të të ardhurave të bashkëshortit.

12.5. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar dhe në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016, konkluzionin e Komisionit për deklarim të rremë të të ardhurave të krijuara prej saj nga ushtrimi i aktivitetit të avokatisë, si dhe për të ardhurat e krijuara nga ushtrimi i aktivitetit privat të bashkëshortit të saj. Subjekti pretendoi gjithashtu qëndrim me standarde të dyfishta nga ana e Komisionit ku, për situata të ngjashme në çështje të tjera rivlerësimi kalimtar, qëndrimi i Komisionit ka qenë në favor të njohjes së të ardhurave të krijuara nga aktiviteti privat sipas deklaramentit të subjektit të rivlerësimit, dhe jo sipas nivelit të përllogaritur sipas një marzhi fitimi të përcaktuar prej tij.

◦ Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “tokë truall” me sip. 360 m², në fshatin {***}, {***} dhe investimin e kryer në këtë sipërfaqe toke:

12.6. Analiza financiare e kryer nga Komisioni për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për blerjen në vitin 2012, të truallit me sip. 360 m², është e gabuar dhe rrjedhojë e konstatimeve të pasakta të likuiditeteve në bankë dhe përllogaritjes së gabuar të shpenzimeve të jetesës. Subjekti pretendoi se, si pasojë e korigjimit të pasaktësive të pretenduara më sipër, viti 2012 rezultoi me një bilanc negativ në vlerën prej 181.274 lekësh, e cila, sipas subjektit, është vlerë e vogël dhe, për rrjedhojë, Kolegji duhet ta vlerësojë këtë rezultat në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

*12.7. Subjekti kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për ndërtim të paligjshëm, duke iu referuar këtu investimit të kryer për ndërtimin në vitin 2013 në tokën me sip. 360 m², në {***}, të një godine dykatëshe me sip. totale ndërtimi 200 m², dhe të legalizuar në vitin 2018.*

12.8. Subjekti kundërshtoi si joobjektiv dhe të pabazuar në fakte konkluzionin tjetër të Komisionit lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të investitorit, z. N. M., në vlerën prej 5.281 eurosh për ndërtimin e godinës 2-katëshe dhe mobilimin e saj, si pasojë e përcaktimit të gabuar të vlerës së shpenzimeve të jetesës për z. M. dhe familjen e tij.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

13. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të

vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, znj. Valbona Seknaj (Durrnjaj), duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

14. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁷ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

15. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 175, datë 04.07.2019, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
16. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën⁸ e deritanishme të Kolegjit, arrin në përfundimin se pretendimet e subjektit të rivlerësimit që lidhen me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të dispozitave kushtetuese lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar dhe atyre të ligjit nr. 84/2016, sipas shkaqeve të ankimit⁹ të parashtruara në paragrafët 11.1 dhe 11.2 në vendim, janë të pabazuara në ligj dhe nuk mund të përbëjnë shkak për cenimin e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit në drejtim të sa më sipër.
17. Sa u takon pretendimeve për proces të parregullt ligjor, në drejtim të cenimit të parimit të barazisë, si pasojë e zhvillimit të procesit të rivlerësimit me standarde të dyfishta, ku për çështje të njëjta Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, ka mbajtur qëndrime të ndryshme në raste të mëparshme të rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues çmon se një pretendim i tillë i subjektit të rivlerësimit nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Trupi

⁷ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 175, datë 04.07.2019, për rivlerësimin e subjektit, znj. Valbona Seknaj (Durrnjaj), i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 19.09.2019, konfirmuar marrja dijeni nga subjekti i rivlerësimit më datë 20.10.2019, sipas lajmërim-marrjes së shërbimit postar. Kurse ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision në datën 03.10.2019, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit, nr. {***}, datë 03.10.2019, që rezulton të jetë dita e 13-të nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrnjaj), e ka dorëzuar ankimin e saj në Komision brenda afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

⁸ Shih vendimet e Kolegjit nr. 12/2018 (JR), nr. 1/2019 (JR), nr. 7/2019 (JR), nr. 8/2019 (JR), nr. 15/2019 (JR), nr. 28/2019 (JR).

⁹ Shih pretendimet e subjektit të rivlerësimit sipas paragrafëve 11.1 dhe 11.2 në këtë vendim.

grykues thekson se çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike, të provuara nga grykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Ndërsa, sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për cenim të parimit për proces të rregullt ligjor, si pasojë e paragrykimit të çështjes dhe paracaktimit të vendimit, si pasojë e faktit se i njëjti trup grykues që ka bërë hetimin administrativ, mbledhjen e provave dhe ngritjen e dyshimeve, ka dhënë edhe vendimin përfundimtar në rolin e gryqtarit, në konflikt të hapur interesi, në kundërshtim me parimin për një grykim të drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe të pandikuar nga faktorë të tjerë, Kolegji e vlerëson këtë shkak të pabazuar në ligj, për sa kohë veprimtaria e trupës grykuese të Komisionit, kompetencat në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar me vendimin e Grykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.01.2017. Në përfundim, trupi grykues nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar grykimin e çështjes në seancë gryqësore publike në prani të palëve.

18. Gjithashtu, në referencë të parashikimeve të dispozitës së sipërcituar, debati gryqësor nuk u vlerësua të jetë i nevojshëm dhe se lidhur me këtë çështje mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, trupi grykues vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

19. Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e deklaramit të pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të në deklaratën e pasurisë vetting, për të cilën subjekti i rivlerësimit pretendoi se përfundimi i arritur nga Komisioni është i pabazuar, trupi grykues konstatoi si vijon.
20. Komisioni, lidhur me vlerësimin e saktësisë së deklaramit të subjektit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë, ka arsyetuar në vendimin e tij: *Komisioni ka evidentuar faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar deklaratën e pasurisë “vetting” në përputhje me ligjin, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurive, duke i vlerësuar ato si pasaktësi në plotësimin e “deklaratës së pasurisë së rivlerësimit kalimtar vetting”. Subjekti i rivlerësimit ka shkelur detyrimin kushtetues dhe ligjor, bazuar në pikat 2 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës; ai duhet të dorëzojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin dhe duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave [...].*
21. Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durraj), kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me mosplotësimin e deklaratës së pasurisë vetting në përputhje me ligjin dhe pretendoi se deklarimet e dhëna prej saj janë të plota, të vërteta dhe të mbështetura në prova. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se në deklaratën e pasurisë vetting ka përfshirë të gjithë pasurinë e saj dhe atë të familjarëve të saj në momentin e dorëzimit dhe burimet e krijimit të tyre që, sipas parashtrimit në ankim, janë: (i) të ardhurat nga puna e saj private si avokate; (ii) të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti i biznesit privat; (iii) të ardhurat nga puna e djalit të subjektit; (iv) të ardhurat nga shitja e apartamentit të banimit me sip. 66 m² në Shkodër; (v) të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Tiranë; (vi) të ardhurat nga shitja e një autoveture; (vii) të ardhurat nga puna e saj si gryqtare nga qershori i vitit 1998 e në vazhdim; si dhe (ix) të ardhurat si lehtësuese në Shkollën e Magjistraturës. Në mbështetje të këtij shkakut ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se mënyra e plotësimit të deklaratës së pasurisë vetting është rrjedhojë e pasaktësisë që ka ndodhur

që në deklaratimet e para periodike pranë ILDKPKI-së, pasaktësi të cilat as nuk janë evidentuar nga inspektorati i ILDKPKI-së, as nuk janë korrigjuar apo asaj t'i jetë dhënë orientim në drejtim të sa më sipër, pavarësisht se ka kaluar tri procedura kontrolli të plotë prej tyre.

22. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, duke marrë në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin e Komisionit dhe arsyetimin e këtij të fundit në vendim, trupi gjykues konstatoi se në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar vetëm pasuritë në pronësi të tyre dhe bashkëpronësi, por nuk kanë deklaruar në asnjë rast burimin e krijimit të tyre.
23. Nga shqyrtimi i legjislacionit në fuqi lidhur me detyrimin për deklaram të pasurive dhe interesave privatë në kuadër të procesit të rivlerësimit, si dhe të mënyrës së deklaramit, trupi gjykues vëren sa më poshtë.
- a) Në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, në pikat 1, 2 dhe 3 të tij, parashikohet shprehimisht: *1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. 2. Subjekti dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. [...]. 3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave [...].*
- b) Në nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikohet se subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të të njëjtit ligj, në të cilën, në informacionin e dhënë në ndihmë të subjekteve deklaruese, në pjesën që i takon deklaramit të pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, thuhet shprehimisht: *Deklarami përfshin pasurinë e subjektit të rivlerësimit dhe të familjes së tij [...], burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit, përfshirë interesat privatë që i ka në pronësi ose në përdorim, sipas nenit 3, pikat 9 dhe 11, të ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.* Në fund të këtij materiali informues, në rubrikën me titull “Sanksionet” përcaktohet: *Mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklarams së pasurisë mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sipas ligjit [...].*
- c) Në faqen 5 të së njëjtës shtojcë të ligjit nr. 84/2016, që përbën edhe formularin e deklarams së pasurisë *vetting*, subjektet e rivlerësimit, në kuadër të deklaramit të pasurive dhe interesave të tyre privatë, udhëzohen shprehimisht si vijon: *Përshkruani hollësisht: llojin sipërfaqen adresën [...] pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.*
- ç) Referuar nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, duhet të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarameve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.
- d) Gjithashtu, në pikën 7 të Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, nr. {***} prot., datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklaramit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklaram të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet shprehimisht: *Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të deklarojnë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre.*

24. Në analizë të parashikimeve të mësipërme ligjore dhe nënligjore, trupi gjykues vlerësoi se Komisioni me të drejtë ka konstatuar se deklarimi i pasurive në deklaratën e pasurisë *vetting*, nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, nuk është kryer në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, parashikimet e të cilit kanë qenë të qarta dhe eksplicite, sa i takon përcaktimit të detyrimit për deklarimin e burimit të krijimit të secilës prej pasurive të deklaruara, detyrim ky i cili u konstatua edhe nga trupi gjykues se nuk është përmbushur nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Trupi gjykues konstatoi se Komisioni e ka kryer kontrollin e secilës prej pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke vlerësuar ligjshmërinë e tyre sipas burimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit të Komisionit të datës 02.04.2019, pasi sikundër edhe është vënë në dukje nga Komisioni, në pyetësorin e sipërcituar, në rezultatet e hetimit, si dhe në vendimin e arsyetuar, subjekti nuk ka deklaruar burimet e krijimit të pasurive dhe interesave privatë të tij dhe të personave të lidhur me të, as në deklaratimet periodike të kryera pranë ILDKPKI-së.
25. Trupi gjykues i gjeti të pabazuara edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit se mosevidentimi nga ana e ILDKPKI-së e problematikave në mënyrën e deklarimit të pasurive gjatë tri procedurave të kontrollit të plotë të kryera prej tij ndër vite, mund të justifikonte deklarimin e saj jo në përputhje me ligjin, për sa kohë detyrimi ligjor ka qenë i shprehur qartë dhe zbatimi i tij është në çdo rast i detyrueshëm dhe i pavarur nga veprimi apo mosveprimi i organit të caktuar për kontrollin e zbatimit të tij. Në përfundim, trupi gjykues arriti në përfundimin se ky shkak ankimi nuk bazohet as në fakte dhe as në ligj dhe, për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit gjendet i drejtë dhe i bazuar.
26. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme “apartament banimi” me sipërfaqe 115,3 m², në adresën rr. “{***}”, shk. {***}, k. {***}, ap. {***}, Tiranë, për të cilën subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit për pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për krijimin e saj, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
27. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me analizën e kryer mbi verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ndër të tjera, si vijon: *Komisioni argumenton se: pagat për periudhën 2004 – 2010, për vitin 2004 janë marrë bazuar në vërtetimin e lëshuar nga institucioni përkatës, ndërsa për vitin 2005 e në vazhdim janë marrë në konsideratë të ardhurat e kaluara në llogarinë bankare të subjektit. Komisioni vlerëson se të ardhurat e deklaruara nga subjekti si të përfituara në formën e dietës, janë vlera monetare të destinuara për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim marrëdhënien e punës [...]. Në lidhje me pretendimin e subjektit për të ardhurat e realizuara nga shitja e apartamentit në Shkodër, Komisioni arsyeton që jemi përpara faktit të hartimit të dy kontratave të shitblerjes për të njëjtën pasuri. Komisioni ka konstatuar se shprehja e vullnetit të subjektit të rivlerësimit për lidhjen e dy kontratave për të njëjtën pasuri, si dhe ndërmarrja e veprime fiktive në ZVRPP-në Tiranë, me qëllim shmangien e të ardhurave të tatueshme për sa i takon regjistrimit të kontratës për kalimin e pronësisë, si dhe çmimit të rremë të transaksionit, janë veprime që cenojnë rëndë pastërtinë e figurës dhe të etikës së magjistratit. Në kuadër të arsyetimit të mësipërm, Komisioni është shprehur në vendim se ka arritur në konkluzionin¹⁰: Përfundimisht, pas ndryshimeve të reflektuara në analizën financiare, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit për periudhën 2004 -2010 ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie në shumën - 3.997.962 lekë.*

¹⁰ Shih faqen 16 të vendimit të Komisionit.

28. Lidhur me vlerësimin e Komisionit për këtë pasuri të paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrnjaj), kjo e fundit ka ngritur këto shkaqe ankimi:

28.1. Analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 2004-2010, e cila rezultoi me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme, në vlerën prej 3.997.962 lekësh, është e gabuar. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se: (i) përllogaritjet matematikore të kryera nga Komisioni janë të pasakta; (ii) analiza për vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme duhej të shtrihet që nga viti 1998 dhe jo nga viti 2004; (iii) përllogaritjet e Komisionit lidhur me shpenzimet e jetesës nuk janë në përputhje me të dhënat e INSTAT-it dhe se të dhënat e marra nga ILDKPKI-ja lidhur me shpenzimet e jetesës nuk i janë bërë me dije nga ana e Komisionit; (iv) të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit nuk janë përfshirë në masën e përfituar dhe të dokumentuar në vërtetimet përkatëse të punëdhënësve; (v) nuk janë përllogaritur në masën e deklaruar të ardhurat nga aktiviteti i avokatisë së subjektit të rivlerësimit, si dhe të ardhurat e realizuara nga aktiviteti privat i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit; (vi) Komisioni duhej të përfshinte në analizë si të ardhura të ligjshme, të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit me sip. 66 m² në Shkodër, në vlerën prej 4.500.000 lekësh, dhe jo vlerën prej 2.000.000 lekësh.

28.2. Konkluzioni i Komisionit për fiktivitet të kontratave noteriale për shitjen e pasurisë së paluajtshme me sip. 66 m² në Shkodër, me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore (evazion fiskal), është i gabuar, pasi sipas subjektit ajo nuk ndodhet në kushtet e kontratave fiktive dhe as të shmangies së detyrimeve tatimore, lidhur me të ardhurat e krijuara nga shitja e kësaj pasurie të paluajtshme. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti parashtrroi se kontratat e shitjes nuk mund të quhen fiktive pasi shitja është realizuar dhe aktualisht kjo pasuri është në pronësi të një personi të tretë, i cili e ka fituar atë si pasojë e tjetërsimit nga znj. L. D. (personi i cilësuar si blerësja në kontratat e shitblerjes të lidhura me subjektin e rivlerësimit, objekt kontrolli nga Komisioni). Gjithashtu subjekti pretendoi se nuk ndodhet në situatën e shmangies nga detyrimet tatimore, për sa kohë ato janë shlyer në përputhje me ligjin, pretenduar kjo si e provuar me vërtetimin nr. {***} prot., datë 25.06.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër. Subjekti gjithashtu kundërshtoi si kontradiktor qëndrimin e mbajtur nga ana e Komisionit lidhur me mosnjohjen si të ardhur të ligjshme të vlerës prej 4.500.000 lekësh të shitjes së apartamentit në Shkodër, me pretendimin se pagesa e detyrimit tatimor është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, ndërkohë që ka njohur si të ligjshme të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e apartamentit të banimit në Tiranë, detyrimet lidhur me tatimet e të cilave janë shlyer po ashtu gjatë procesit të rivlerësimit.

29. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, i cili lidhet kryesisht me analizën financiare të kryer nga ana e Komisionit në drejtim të verifikimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë së paluajtshme “apartament banimi”, me vendndodhje në rrugën “{***}”, Tiranë, trupi gjykues konstatoi se konkluzioni i Komisionit për pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme në krijimin e kësaj pasurie, në vlerën prej 3.997.962 lekësh, mbështetet kryesisht në rezultatin negativ financiar prej 3.683.222 lekësh të vitit 2004, vit në të cilin është paguar edhe kësti i parë i çmimit të apartamentit, në vlerën e 45.000 eurove¹¹. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi të fokusohet në analizimin e pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj, lidhur me transaksionin e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me sip. 66 m² në qytetin e Shkodrës, të ardhurat e të cilit janë pretenduar prej saj në vlerën e 4.500.000 lekëve

¹¹ Konvertuar në 5.703.300 lekë sipas kursit mesatar mujor të Bankës së Shqipërisë për muajin dhjetor 2004, në vlerën 126,74 lekë/1 euro.

(përkundër vlerës 2.000.000 lekë, të përlogaritur nga Komisioni), si dhe janë deklaruar se kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë së paluajtshme të blerë në Tiranë.

30. Në vijim të sa më sipër, sa i takon shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit sipas paragrafit 28.2 më sipër në vendim, nga verifikimi i akteve të fashikullit të përcjellë nga Komisioni lidhur me transaksionin objekt kontrolli dhe të ardhurat e krijuara si pasojë e tij, trupi gjykues konstatoi faktet dhe rrethanat e mëposhtme.

a) Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj, dhe sipërmarrësi investitor, z. T. M., më datë 08.12.2004, kanë lidhur një kontratë sipërmarrjeje, me objekt “porosi për blerjen e një apartamenti banimi, pas disa kohe: me mbarimin e objektit dhe regjistrimin e tij në ZVRPP”. Sipas kësaj marrëveshjeje, palët kanë rënë dakord që apartamenti i porositur, ndër të tjera, do të ketë sipërfaqe ndërtimi 130,33 m², sip. shfrytëzimi 99,52 m² dhe çmimi i shitjes së tij caktohet në vlerën 78.000 euro, për t’u paguar me tri këste, respektivisht: *1. kësti i parë prej 45.000 eurosh, i cili do të paguhet me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes, nga të cilat vlera prej 5000 eurosh përbën kapar; 2. kësti i dytë prej 30.000 eurosh, për t’u paguar më datë 05.02.2005, me dorëzimin e çelësave të apartamentit; dhe 3. kësti i tretë prej 3000 eurosh, i cili do të paguhet në momentin e regjistrimit të apartamentit.*

b) Në përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me pyetjen e Komisionit mbi deklarimin e burimit/eve për krijimin e pasurisë apartament banimi me sip. 115,3 m² në rrugën “{***}”, në Tiranë, subjekti ka deklaruar si një ndër burimet financiare për financimin e blerjes së këtij apartamenti edhe të ardhurat e krijuara nga shitja e një apartamenti banimi në Shkodër, më konkretisht si vijon: *Fillimisht dua të deklaroj se ky apartament banimi, në adresën rr. {***}, shk. {***}, k. {***}, ap. {***}, Tiranë, është blerë me kontratën e sipërmarrjes dt. 08.12.2004, në vlerën 78.000 euro, me të ardhura të krijuara ndër vite nga biznesi privat i të dyve të akumuluar e më pas nga paga. Nga shitja e një apartamenti banimi në Shkodër me kontratën e shitjes nr. rep. {***}, kol. {***}, dt. 05.11.2004, në vlerën 4.500.000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë. [...]. Këtë pasuri të blerë në 2001, e kam blerë me kursimet e mia të akumuluar ndër vite që rrjedhin nga biznesi privat e puna e të dy bashkëshortëve dhe kjo pasuri është shitur më dt. 05.11.2004, me çmim shitje 4.500.000 lekë, ka qenë një burim shtesë për blerjen e apartamentit në Tiranë, me kontratë sipërmarrje dt. 08.12.2004.*

c) Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, vihet re se subjekti i rivlerësimit dhe znj. L. D. kanë lidhur një kontratë noteriale “Për shitblerje pasurie të paluajtshme apartament banimi (me këste)” me nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, dt. 05.11.2004, pranë noteres E. A., sipas së cilës subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e palës shitëse bie dakord t’i shesë znj. D. pasurinë e paluajtshme “apartament”, me sip. 66 m², kundrejt çmimit të shitjes të caktuar në vlerën 4.500.000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë, shumë e cila do të likuidohet me këste. Referuar parashikimeve në kontratë: *kësti i parë prej 3.500.000 lekësh është likuiduar me nënshkrimin e kontratës më datë 05.11.2004, ndërsa kësti i dytë, në vlerën prej 1.000.000 lekësh do të likuidohej deri më datë 30.05.2005. Me likuidimin e kështit të fundit, blerësit i lind e drejta të regjistrojë aktin e shitblerjes në emër dhe për llogari të tij pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Shkodër [...].*

ç) Referuar deklaratës noteriale me nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 13.09.2005, përpara noteres E. A., palët kanë rënë dakord: *Më datën 05.11.2004 kemi nënshkruar një akt shitblerje apartament banimi (me këste), me nr. rep. {***} dhe nr. kol. {***}, për pasurinë {***} volumi {***}, faqe {***}, Zona Kadastrale {***} me sipërfaqe 66 m². Në kontratë është parashikuar që likuidimi i kështit të dytë prej 1.000.000 lekësh të reja, të bëhet brenda datës 30 gusht 2005. Mirëpo ne kemi rënë dakord ta shtyjmë afatin e pagimit të këtij kësti deri më 30 gusht 2006, moment kur do të nënshkruhet dhe akti përfundimtar i shitblerjes së pasurisë së paluajtshme apartament banimi.*

d) Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës verifikuese të kryer nga ILDKPKI-ja, rezultoi se me shkresën nr. {***} prot., datë 03.10.2017, të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme është përcjellë si pjesë e praktikës së regjistrimit të apartamentit të banimit me sip. 66m² në Shkodër, një kontratë noteriale shitblerje pasurie të paluajtshme me nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 19 dhjetor 2005, pranë noterit A. K., me palë shitëse subjektin e rivlerësimit dhe palë blerëse znj. L. D., sipas parashikimeve të së cilës ato kanë shprehur dakordësinë si vijon: *3.1 Shitësja i shet blerëses krejt pronën e përshkruar në pikën 1.1 të kësaj kontrate. [...] 4.1 Çmimi i shitjes së pronës është 2.000.000 (dy milionë) lekë të reja. [...] 6.1 Pala shitëse është e detyruar të paguajë tatimin mbi çmimin e shitjes pranë Zyrës së RPP¹² të rrethit Shkodër, që në këtë rast është në shumën 0,5% të këtij çmimi (pasi shuma nuk e kalon vlerën 2.000.000) e konkretisht shuma 10.000 lekë të reja [...].*

dh) Gjatë verifikimit të dokumentacionit të administruar nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me shkresën nr. {***} prot., datë 03.10.2017, rezultoi se pjesë e praktikës së regjistrimit të pasurisë objekt kontrolli ishte edhe një mandat arkëtimi, me datë lëshimi 20.12.2005, sipas të cilit provohej se subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Durraj, emri i së cilës paraqitet në cilësinë e arkëtueses, ka paguar shumën prej 10.000 lekësh, me përshkrimin për veprimin e kryer *“tatim të ardhura nga shitja”*. Sipas përlllogaritjes së shprehur në këtë mandat arkëtimi, vlera e tatimit të paguar i korrespondon 0,5% të shumës prej 2.000.000 lekësh, e cila përputhet me vlerën e përcaktuar në kontratën noteriale të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme apartament banimi me sip. 66 m², me nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, të datës 19.12.2005, të dhëna këto të referuara shprehimisht edhe në mandatarëkëtimin e sipërcituar.

e) I njëjti informacion si më sipër, cituar në paragrafët (d) dhe (dh), është përcjellë nga ZVRPP Shkodër me shkresën nr. {***}, datë 19.12.2018 edhe drejt Komisionit, në kuadër të hetimit administrativ të kryer lidhur me praktikën me nr. reference {***}, që i takon regjistrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme “apartament banimi” me sip. 66 m² nga subjekti i rivlerësimit te znj. L. D.

31. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të sa më sipër referuar, trupi gjykues, pasi konstatoi se:
- a) për të njëjtin veprim juridik, shitblerjen e një pasurie të paluajtshme, janë hartuar në momente të ndryshme kohore, dy kontrata noteriale në prani jo të të njëjtit noter dhe me çmime të ndryshme shitjeje;
 - b) pranë ILDKPKI-së subjekti ka deklaruar si të ardhura nga shitja e pasurisë së paluajtshme vlerën prej 4.500.000 lekësh (sipas kontratës së parë të lidhur në vitin 2004), përkatësisht 3.500.000 lekë janë deklaruar si të ardhura të realizuara në deklaratën periodike të vitit 2004 dhe 1.000.000 lekë janë deklaruar si të ardhura nga shitja të realizuara nga shlyerja e këstit të dytë në deklaratën periodike të vitit 2005; ndërsa
 - c) për efekt regjistrimi pranë ZVRPP-së, rezultoi se kalimi i titullit të pronësisë së kësaj pasurie të paluajtshme është vërtetuar pranë organit kompetent sipas kontratës së dytë noteriale të lidhur në vitin 2005, ku çmimi i shitjes është përcaktuar në vlerën prej 2.000.000 lekësh dhe se tatimi mbi të ardhurat e realizuara nga shitja e kësaj pasurie është paguar sipas çmimit të shitjes të kësaj kontrate, që përfaqëson vlerën më të ulët të të ardhurave të “realizuara” dhe njëkohësisht pragun maksimal të së ardhurës së tatueshme me 0,5% të çmimit të shitjes¹³;

¹² Akronim për zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

¹³ Referuar përcaktimeve në legjislacionin e kohës detyrimi tatimor për të ardhurat e krijuara nga kalimi i pronësisë së paluajtshme përcaktohej mbi bazë përqindjeje mbi çmimin e shitjes, sipas niveleve: 0 - 2.000.000 lekë tatoseshin me 0,5%, 4.000.000 - 6.000.000 lekë tatoseshin 1%, ndërsa për çmim të shitjes mbi 6.000.000 lekë, tatimi ishte në masën 3%.

– krijoi bindjen se mes subjektit të rivlerësimit dhe znj. L. D. ka pasur një përputhje vullneti për të paraqitur përpara ZVRPP Shkodër, si çmim për transaksionin e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme objekt kontrolli, një vlerë më të vogël se ajo e realizuar, dhe kjo me qëllim shmangien e detyrimit tatimor mbi të ardhurat e realizuara, minimalisht për vlerën prej 3.500.000 lekësh, të përfituar që me nënshkrimin e kontratës noteriale në vitin 2004.

32. Trupi gjykues çmoi se sa më sipër përforcohet edhe nga fakti se pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme rezulton të jetë kryer nga vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Durraj, në dhjetor të vitit 2005. Ky fakt hedh poshtë gjithashtu edhe pretendimet e vetë subjektit të rivlerësimit se vlera prej 2.000.000 lekësh në kontratën e dytë të shitblerjes ka qenë një gabim i noterit, duke qenë se sipas saj përkonte me vlerën e këstit të dytë prej 1.000.000 lekësh dhe jo me çmimin e plotë të blerjes së pasurisë dhe se është nënshkruar prej saj në mirëbesim, rast ky në të cilin subjekti, i ndodhur në mirëbesim, do duhet të kishte paguar pranë ZVRPP-së vlerën e tatimit për çmimin e shitjes prej 4.500.000 lekësh, dhe jo atë sipas përcaktimit në kontratën e dytë noteriale, referuar të ardhurës nga shitja prej 2.000.000 lekësh. Pretendimet për pagesë të mëvonshme gjatë procesit të rivlerësimit të detyrimit tatimor, sipas vlerës së plotë të të ardhurave të realizuara, u gjykuan nga ana e trupit gjykues pa efekt në vlerësimin e çështjes konkrete, për sa kohë nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit nuk u konstatua asnjë fakt, i cili të provonte se mospagesa e tatimit për vlerën e plotë të përfituar nga shitja e pasurisë së paluajtshme ishte “jo për faj të subjektit të rivlerësimit”.
33. Përfundimisht, trupi gjykues arriti në konkluzionin se ky shkak ankimi nuk mbështetet në fakte. Rrjedhimisht, edhe pse veprimi juridik i shitblerjes së kësaj pasurie të paluajtshme sipas kontratës noteriale të datës 05.11.2004, i ka prodhuar pasojat juridike të synuara, kalimin e titullit të pronësisë së kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit të blerësj L.D, sipas kushteve thelbësore të kontratës së dakordësuar mes tyre, në të cilat përfshihet edhe çmimi i shitjes, për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe vlerësimit të ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga kjo shitblerje në përputhje me standardin e përcaktuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, Komisioni me të drejtë ka vlerësuar si të ardhura të ligjshme, duke i përfshirë në analizën përkatëse financiare, vlerën prej 2.000.000 lekësh, për të cilën janë shlyer detyrimet tatimore ndaj shtetit, dhe jo vlerën prej 4.500.000 lekësh, e cila përbën çmimin e shitjes së pasurisë në fjalë dhe vlerën monetare të përfituar *de facto* nga subjekti i rivlerësimit.
34. Ndërkohë, sa u takon elementeve të tjera të analizës financiare të kryer nga Komisioni, më konkretisht, të ardhurave nga paga të subjektit të rivlerësimit, të cilat pretendohen se nuk janë përfshirë në masën e përfituar dhe të dokumentuar në vërtetimet përkatëse të punëdhënësve, pagesave të përfituara në formën e dietave të cilat nuk janë përllogaritur në të ardhurat e hyra, si dhe vlerës së shpenzimeve të jetesës të cilat pretendohet nga subjekti i rivlerësimit se janë marrë nga ILDKPKI-ja dhe nuk i janë bërë me dije nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi se pretendimet e ngritura në ankim nga subjekti i rivlerësimit lidhur me trajtimin e këtyre elementeve nga ana e Komisionit, janë të njëjta me pretendimet e ngritura edhe para Komisionit, për të cilat ky i fundit ka arsytuar në mënyrë të plotë¹⁴ qëndrimin e tij në vendim, qëndrim i cili pas verifikimit nga ana e Kolegjit, u gjet i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe në ligj, si dhe në harmoni të plotë me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit.
35. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se analiza financiare për vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme, ndryshe nga sa ka vepruar Komisioni, do duhej të ishte shtrirë nga viti 1998 dhe jo nga viti 2004, trupi gjykues,

¹⁴ Shih faqe 14 dhe 15 të vendimit të Komisionit.

pasi analizoi faktet me rëndësi lidhur me krijimin e kësaj pasurie, arriti në përfundimin se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar në fakte. Ky konkluzion bazohet mbi të gjitha në vetë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së në deklaratën për herë të parë të dorëzuar në vitin 2004, ku subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë deklaruar kursime në gjendje *cash* me burim të ardhurat nga pagat ndër vite dhe të vetmet kursime të deklaruara në formën e likuiditetit *cash* në masën e 300.000 lekëve (me burim shitjen e automjetit tip “Ford”) rezultoi të mos i ketë përdorur si burim për blerjen e apartamentit, duke qenë se ky kursim është deklaruar ekzistues edhe në fund të vitit 2004, në deklaratën periodike të këtij viti. Në këto kushte, Komisioni me të drejtë ka përcaktuar si periudhë kohore gjatë së cilës duhet të kryente analizën financiare për efekt të vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, periudhën kohore nga viti 2004 (vit gjatë të cilit është kryer pagesa e kështit të parë të çmimit të apartamentit) deri në vitin 2010 (vit në të cilin është shlyer kësti i fundit i huas së marrë vëllait të subjektit të rivlerësimit, hua kjo e cila është deklaruar si një ndër burimet e krijimit të pasurisë objekt kontrolli).

36. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj, se të ardhurat e saj nga ushtrimi i aktivitetit të avokatisë në periudhën gusht 1992 – dhjetor 1997, si dhe të ardhurat e realizuara nga aktiviteti privat i bashkëshortit të saj (vitet 1991-2015) nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni në masën e deklaruar prej tyre në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke sjellë si pasojë reduktimin e burimeve të ligjshme të të ardhurave të përdorura për blerjen e apartamentit, trupi gjykues vlerësoi fillimisht që në kuadër të analizës financiare për vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për justifikimin e blerjes në vitin 2004 të pasurisë së paluajtshme “apartament banimi” dhe në dritën e konkluzionit të arritur në paragrafin e mësipërm në vendim lidhur me periudhën kohore gjatë së cilës duhej të shtrihej kjo analizë, vetëm të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës 2004 - 2010 mund të sjellin pasojë në analizën e kryer dhe, për rrjedhojë, vetëm pretendimet lidhur me këto të ardhura dhe mënyra e trajtimit të tyre nga Komisioni do të merret në shqyrtim nga trupi gjykues, në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi.
37. Nga marrja në analizë e të ardhurave të sipërcituara, për efekt të përlllogaritjes së vlerës së tyre që do të konsiderohet si e hyrë në analizën financiare të viteve 2004-2010, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në analizën e tij financiare¹⁵, ka përfshirë në rubrikën e të ardhurave të bashkëshortit të subjektit, për vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009 dhe 2010 respektivisht vlerat 296.340 lekë, 480.000 lekë, 645.000 lekë, 615.000 lekë, 765.000 lekë, 747.000 lekë dhe 540.516 lekë, në total për gjithë periudhën vlerën prej 4.088.856 lekësh. Ndërkohë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike pranë ILDKPKI-së për këto vite, si dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, respektivisht vlerat 1.200.000 lekë, 1.200.000 lekë, 1.300.000 lekë, 1.200.000 lekë, 1.000.000 lekë, 1.200.000 lekë dhe 1.000.000 lekë, në total vlerën prej 8.100.000 lekësh.
38. Nga sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se përlllogaritja e të ardhurave të krijuara nga bashkëshorti i saj në formën e fitimit neto nga aktiviteti privat për vitet 2005 dhe 2006, është bërë me qëllim për t'i zvogëluar ato, duke sjellë si pasojë një rezultat që nuk përputhet me faktin, të dhënat zyrtare të organit tatimor dhe legjisllacionin e zbatueshëm në fuqi, është një pretendim i pabazuar në fakte. Trupi gjykues vëren se ndonëse Komisioni, sikundër pretendon edhe subjekti i rivlerësimit, në tabelën nr. 1 në vendimin e tij ka përlllogaritur për vitet 2005 dhe 2006 vlerën e fitimit neto nga aktiviteti sipas aplikimit të marzhit

¹⁵ Shih tabelën nr. 4, në faqen 16 të vendimit të Komisionit.

të fitimit prej 15% mbi një xhiro të përlllogaritur¹⁶ prej tij (Komisionit) përkatësisht në vlerat 264.825 lekë dhe 179.768 lekë, në tabelën nr. 3¹⁷ me të cilën subjektit i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit financiar negativ sipas të dhënave të kësaj tablele, sikundër dhe në variantin final të analizës financiare të Komisionit të përgatitur pas vlerësimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, të pasqyruar në tabelën nr. 4 të vendimit, të ardhurat nga aktiviteti i personit fizik E. S. janë paraqitur në vlera dukshëm më të larta, përkatësisht 480.000 lekë dhe 645.000 lekë.

39. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se, referuar korrespondencës së Komisionit me Drejtorinë Rajonale Shkodër, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 21.11.2018 dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, nga verifikimi i kryer nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në formën e fitimit (pas tatimit) të personit fizik nga ushtrimi i aktivitetit privat “market ushqimor” për periudhën e viteve 2005-2010 janë respektivisht 303.700 lekë, 409.630 lekë, 614.900 lekë, 765.000 lekë, 747.000 lekë dhe 540.516 lekë, në total 3.380.746 lekë. Vlerat e sipërcituara, për vitet 2008-2010, përfaqësojnë fitimin pas tatimit i cili vjen si diferencë e fitimit të tatueshëm me vlerën e detyrimit tatimor. Ndërkohë për vitet 2005 dhe 2006, vlerat e sipërpërmendura përfaqësojnë diferencën mes vlerave të blerjeve dhe të shitjeve të personit fizik dhe vlerës së tatimit të paguar, duke qenë se këto të dhëna janë të përcaktuara në formularët e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për tatimpaguesin E. S. me NIPT {***}.
40. Nga krahasimi i vlerave të përmendura në paragrafët e mësipërm, trupi gjykues vëren se konkretisht për vitet 2005 dhe 2006, Komisioni edhe pse ka pasur të dhëna të mjaftueshme për t'i mundësuar përlllogaritjen e fitimit neto, duke qenë se për tatimpaguesin në fjalë disponohej niveli i blerjeve dhe shitjeve të kryera gjatë vitit, si dhe vlera e detyrimit tatimor të paguar, ka përlllogaritur fitimin e realizuar sipas një metodologjie mbi bazën e një marzhi fitimi prej 15% të qarkullimit vjetor, përlllogaritje e cila ka rezultuar me një fitim neto më të lartë për z. E. S. sesa fitimi i përlllogaritur mbi bazën e të dhënave të organit tatimor (shitjet vjetore – blerjet vjetore – tatimin e paguar = fitimi neto i realizuar).
41. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se mënyra e përlllogaritjes nga ana e Komisionit sipas metodologjisë së përcaktimit të fitimit mbi bazën e një marzhi mbi qarkullimin e kryer nuk ka cenuar nivelin e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë ato paraqiten në vlera më të larta sesa ka qenë fitimi i realizuar. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i bazuar në fakte. I pabazuar në fakte vlerësohet edhe pretendimi për mosmarrjen në konsideratë të të ardhurave të krijuara nga aktiviteti privat për vitet 2008, 2009 dhe 2010, në masën e deklaruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë që të ardhurat e krijuara për këto vite, përkundër të dhënave të konfirmuara nga organi tatimor, janë në nivelin e deklarimit të tyre në deklaratën e pasurisë *vetting*.
42. Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit për përlllogaritje të pasakta matematikore të kryera nga Komisioni, si pasojë e mbledhjes vetëm të vlerave negative të rezultuara nga analiza financiare e viteve 2004-2010 dhe jo të mbledhjes së vlerave negative me vlerat e rezultuara pozitive të cilat sipas subjektit do të paraqisnin bilancin real të viteve të marra në analizë, trupi gjykues, pasi verifikoi nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor vlerat e rezultuara për secilin prej

¹⁶ Përcaktimi i xhiros vjetore është bërë duke marrë për bazë parashikimin ligjor të kohës mbi përcaktimin e detyrimit tatimor mbi qarkullimin vjetor.

¹⁷ Në këtë tabelë paraqitet analiza financiare për periudhën 2004-2010.

viteve të periudhës së analizuar, arriti në përfundimin se Komisioni, në kuadër të vlerësimit të mjaftueshmërisë apo jo të burimeve të ligjshme financiare për të kryer financimin e blerjes së apartamentit objekt kontrolli, me të drejtë ka përcaktuar rezultatin final nëpërmjet mbledhjes së vlerave negative të rezultuara nga analiza e viteve individuale. Këto rezultate, në vlerësim të Kolegjit, përcaktojnë vlerën e burimeve monetare të munguara për të konsideruar si të ligjshme shpenzimet dhe investimet e kryera gjatë viteve të marra në analizë. Këto burime të munguara gjatë viteve përkatëse nuk mund të kompensohen me rezultatet pozitive të viteve të cilat kanë rezultuar të tilla, të cilat përfaqësojnë probabilitet mundësinë e subjektit për të kursyer vlerat në fjalë, por jo kursime gjendje në fund të vitit dhe të përdorura në vijim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, sa kohë një fakt i tillë nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike dhe nuk u provua gjatë procesit të rivlerësimit si një fakt i vërtetë. Ky konkluzion i trupit gjykues përbën tashmë një qëndrim të konsoliduar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit¹⁸.

43. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj, nuk arriti të provojë, bazuar në fakte dhe në ligj, pretendimet e saj për konkluzion të gabuar të Komisionit në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë së paluajtshme “apartament banimi” me sip. {***} m², në adresën rr. “{***}”, Tiranë, në shumën e 3.997.962 lekëve.
44. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “dyqan” me sip. 46 m² në Shkodër, blerë në vitin 1997 dhe pjesën e pandarë të dyqanit me sip. 10 m², blerë në vitin 2006*, subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së dyqanit me sip. 46 m² në vitin 1997, dhe të sipërfaqes prej 10 m² në vitin 2006, pjesë e pandarë e dyqanit të blerë në vitin 1997, është i gabuar pasi nuk është llogaritur në mënyrë të saktë niveli i të ardhurave të subjektit dhe bashkëshortit të saj për periudhën 1989-1997, dhe nuk janë përfshirë një pjesë e të ardhurave të bashkëshortit në analizën e vitit 2006.
45. Në analizë të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar në fashikullin e Komisionit, vëren se sa u takon të ardhurave të subjektit të rivlerësimit nga ushtrimi i aktivitetit të avokatisë, subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* se për periudhën 22.08.1992 – 31.12.1997, ka krijuar të ardhura në vlerën e 6.800.000 lekëve gjithsej. Ndërkohë Komisioni është shprehur në vendim: *Komisioni shqyrtoi legjislacionin përkatës tatimor për çdo vit dhe në bazë të të dhënave për tatimin e paguar nga aktiviteti si avokate, përlllogaritë qarkullimin, si dhe fitimin faktik për periudhën 1992-1997 [...] nga përlllogaritjet e të cilit rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur fitim faktik të përlllogaritur në vlerën e 1.899.000 lekëve.*
46. Në shqyrtim të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues çmon se: (i) në mungesë të të dhënave zyrtare mbi qarkullimin e kryer, si dhe fitimin e realizuar nga subjekti i rivlerësimit nga ushtrimi i profesionit të avokatit; (ii) ndodhur në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë krijimin e të ardhurave nga ushtrimi i profesionit të avokatit në vlerat e deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*; dhe (iii) me qëllim arritjen në një vendimmarrje sa më të drejtë – Komisioni me të drejtë, bazuar në parashikimet ligjore mbi përcaktimin e detyrimit tatimor për aktivitetin e ushtruar, ka kryer përlllogaritje fillimisht në drejtim të përcaktimit të qarkullimit vjetor dhe në vijim, të përcaktimit të të ardhurave neto të realizuara duke aplikuar një marzh fitimi prej 80% të vlerës së qarkullimit vjetor.

¹⁸ Shih parag. 113 të vendimit të Kolegjit nr. 17 (JR), datë 15.07.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit A.V.

47. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj, se Komisioni ka vepruar në shkelje të ligjit kur ka përcaktuar xhiron vjetore për vitet e ushtrimit të aktivitetit të saj privat, bazuar mbi tatimin e paguar, pasi sipas saj tatimi në atë periudhë ka qenë me vlerë fikse dhe se vetë organi tatimor i cili ka përcaktuar vjeljen e detyrimit me tarifë fikse nuk ka bërë kontroll as për xhiron, as për shpenzimet e kryera dhe as ka përcaktuar fitimin neto, gjendet nga trupi gjykues i pabazuar në ligj. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mban parasysh parashikimin ligjor të kohës, më konkretisht dispozitat e ligjit nr. 7679, datë 03.03.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”. Referuar nenit 2 të këtij ligji, subjektet që ushtrojnë veprimtari private të pavarur me qëllime fitimprurëse në tregti, në artizanat, në shërbime të ndryshme, përfshirë këtu dhe avokatinë, i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat që realizojnë, tatim ky i cili llogaritet me tarifa proporcionale mbi të ardhurat që realizohen nga shitja ose nga kryerja e shërbimeve, si dhe me kuota fikse. Në kategorinë e bizneseve të cilat tatheshin me tarifa proporcionale mbi të ardhurat që realizonin nga shitja ose nga kryerja e shërbimeve, renditen edhe avokatët, masa e tatimit për të cilët përcaktohej në vlerën 8%. Pretendimi i subjektit, znj. Valbona Seknaj, në parashtrimet e saj para Kolegjit se, referuar “Fletë njoftimit të tatimit” të datës 08.12.1997, tatimi i cili i është vendosur është tatim fiks, u gjet nga Kolegji i pabazuar në fakte dhe në ligj. Trupi gjykues konstatoi se në këtë fletë njoftimi mbi tatimin për t’u paguar, zyra e tatimeve të rrethit Shkodër i ka përllogaritur një shumë tatimi mbi të ardhurat në vlerën e 40.000 lekëve, të ndarë në 4 këste për çdo tremujor. Kjo vlerë tatimi e pretenduar nga subjekti si tatim fiks, edhe pse referuar parashikimeve ligjore të sipërcituara është caktuar nga organi tatimor sipas përllogaritjes së kryer të vlerës prej 8% mbi deklaratën vjetore parashikuese të të ardhurave të bërë nga tatimpaguesi dhe verifikimeve të bëra nga punonjësit e organeve tatimore, rezulton të mos përputhet me asnjë nga vlerat fikse të tatimit të përcaktuara si kuotë vjetore, sipas nenit 4 të ligjit nr. 7679, datë 03.03.1993. Gjithashtu, trupi gjykues konstatoi edhe se referuar parashikimit të nenit 6 të po të njëjtit ligj, tatimi i llogaritur me tarifa proporcionale mbi të ardhurat paguhet në 4 këste gjatë vitit, sikundër rezulton në rastin e subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që tatimi me kuota fikse derdhet në mënyrë të barabartë për çdo muaj.
48. Sa u takon pretendimeve për metodologjinë e përdorur nga Komisioni për përcaktimin e fitimit neto të realizuar nga subjekti i rivlerësimit mbi bazën e aplikimit të një marzhi fitimi prej 80% mbi qarkullimin vjetor, si një veprim të Komisionit në kundërshtim me ligjin si pasojë e tejkallimit të kompetencave të tij, trupi gjykues i gjen këto pretendime të pabazuara dhe çmon si të drejtë dhe favorizuese për subjektin e rivlerësimit këtë qasje të Komisionit për përcaktimin e një vlere të të ardhurave të krijuara nga aktiviteti privat, sa më pranë realitetit që dëshmon dokumentacioni i administruar, të ardhura këto të cilat subjekti i rivlerësimit, në kuadër të detyrimeve që i lindin nga procesi i rivlerësimit, nuk arriti t’i provonte në nivelin e deklaramit të tyre në deklaratën e pasurisë *vetting*, me dokumentacion justifikues, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit për të përfshirë në analizën financiare për periudhën 1989-1997, lidhur me vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për blerjen në vitin 1997 të dyqanit me sip. 46 m² në Shkodër, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga avokatia, në vlerën prej 1.899.000 lekësh.
49. Në përfundim të analizës lidhur me të ardhurat e krijuara nga subjekti i rivlerësimit nga ushtrimi i aktivitetit të avokatisë, sa i takon pretendimit për konkluzion të gabuar të Komisionit për deklarim të rremë të këtyre të ardhurave, trupi gjykues çmoi se, pavarësisht faktit se nga analiza e mësipërme Komisioni dhe Kolegji arrijnë në përfundimin se të ardhurat e krijuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të aktivitetit të avokatisë, të cilat përmbushin standardet e ligjshmërisë sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, nuk përputhen në vlerë me të ardhurat e deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*, në

kushtet kur nga hetimi administrativ nuk u administrua asnjë dokumentacion zyrtar që provon vlerën e saktë të këtyre të ardhurave, subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me pasojat e deklarimit të rremë. Deklarimi i subjektit në këtë rast vlerësohet nga ana e trupit gjykues si deklarim i pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, referuar parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

50. Në lidhje me të ardhurat e krijuara nga aktiviteti privat i ushtruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në periudhën deri në vitin 1997, trupi gjykues vlerëson se, në parim, analiza e kryer mbi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe arsyetimi ligjor i parashtruar më sipër në vendim do të vlente njësoj edhe për trajtimin e të ardhurave të krijuara nga bashkëshorti i saj në formën e fitimit neto nga aktiviteti “market ushqimor”, për sa kohë referuar natyrës së aktivitetit të ushtruar nga z. E. S., të ardhurat e krijuara prej tij i nënshtrohen zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 7679, datë 03.03.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, me të njëjtin regjim tatimor si në rastin e aktivitetit të avokatisë, me tarifë proporcionale në vlerën 5% mbi të ardhurat nga shitjet e realizuara. Megjithatë, trajtimit sipas arsyetimit të mësipërm, nuk i nënshtrohen të ardhurat e deklaruara për vitet 1996 dhe 1997, për të cilat, referuar dokumentacionit të administruar nga organi tatimor gjatë hetimit administrativ, nuk rezultoi të jetë paguar tatim mbi të ardhurat e biznesit të vogël dhe, për rrjedhojë, të ardhurat e deklaruara në formën e fitimit neto për këto dy vite nuk përmbushin standardet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës për t’u vlerësuar të ardhura të ligjshme dhe, si të tilla, të përfshihen në rubrikën e të hyrave për vitet në fjalë.
51. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat e krijuara nga aktiviteti privat i bashkëshortit për vitin 2006, të cilat ndikojnë në analizën financiare për verifikimin e burimeve të ligjshme për blerjen e sipërfaqes shtesë të dyqanit, prej 10 m², në vitin 2006, trupi gjykues është shprehur lidhur me këto të ardhura në paragrafët 38 e vijues, më sipër në vendim.
52. Në përfundim të sa më sipër, pas verifikimit të kryer nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues konstatoi se analiza financiare e kryer nga Komisioni lidhur me kontrollin e burimeve të ligjshme për krijimin në vitin 1997 të pasurisë së paluajtshme “dyqan” me sip. 46 m² në Shkodër dhe shtimit të kësaj pasurie në vitin 2006 nëpërmjet blerjes së një sipërfaqeje shtesë prej 10 m², është e saktë. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit, i bazuar në rezultatin e kësaj analize, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (bashkëshorti E. S.) kanë mungesë burimesh të ligjshme financiare në total në shumën 3.631.063 lekë, për blerjen e dyqanit në vitin 1997 dhe sipërfaqen shtesë prej 10 m² në vitin 2006, gjendet i drejtë dhe i bazuar.
53. Në lidhje me shkakun e ankimit mbi kundërshtimin si të gabuar të konkluzionit të Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti privat i bashkëshortit për periudhën 2003-2016, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të shkaqeve që justifikojnë, sipas subjektit të rivlerësimit, mospërputhjet mes deklaramëve periodike dhe të dhënave të administruara nga organi tatimor lidhur me fitimet e realizuara nga aktiviteti privat, vlerësoi se, në kushtet kur për disa vite të aktivitetit privat mungojnë të dhënat e plota zyrtare të organit kompetent mbi fitimet neto të personit fizik E. S., duhet pranuar pretendimi i subjektit se nuk jemi para një deklarimi të rremë. Megjithatë, për sa kohë subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj, nuk arriti të provojë se të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit të saj nuk janë në nivelin e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, por dukshëm më të ulëta, ky deklarim konsiderohet nga trupi gjykues si i pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, në kuptim të parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
54. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “tokë truall” me sip. 360 m², në fshatin {***}, {***} dhe investimin e kryer në këtë sipërfaqe toke, trupi gjykues konstaton si më poshtë.*

55. Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me këtë pasuri të paluajshme: *Nga vlerësimi i analizës financiare të kryer, pretendimeve të subjektit, si dhe duke reflektuar ndryshimet, rezultoi se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme për të blerë tokën në fshatin {***}, {***}, pasi ka balancë financiare negative për vitin 2012, në shumën -680.089 lekë.*

Për sa më sipër, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi për këtë pasuri, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në përputhje me germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

*Nga hetimi i kryer, Komisioni konstatoi se as subjekti i rivlerësimit dhe as sipërmarrësi/investitori, nuk kanë aplikuar për t’u pajisur me leje ndërtimi për godinën 2-katëshe, në {***}, përpara se të niste ndërtimin e kësaj godine. Në fazën kur ishte bërë një pjesë e investimit (në nivel karabinaje) është bërë aplikimi për legalizim nga bashkëshorti i subjektit [...]. Komisioni, në lidhje me pasurinë godinë 2-katëshe me sip. 200 m², mbi truall me sip. 360 m², në fshatin {***}, {***}, ka konstatuar se subjekti ka kryer ndërtim të paligjshëm në vitin 2013. Ndërtimet e paligjshme nga dhjetori i vitit 2014, parashikohen si vepër penale referuar nenit 199/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.*

[...] Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk provoi me dokumentacion se investitori N.M. ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për ndërtimin e godinës 2-katëshe + mobilim.

*Për sa më sipër, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi, trupi gjykues çmon se pretendimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi subjekti nuk provoi burimet e ligjshme për krijimin e pasurisë godinë 2-katëshe, ndodhur në {***}. Trupi gjykues, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuar së bashku, si dhe shqyrtimin e rrethanave në tërësi, çmon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, në përputhje me germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

56. Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrëj), kundërshtoi konkluzionin e mësipërm të Komisionit sipas shkaqeve të ngritura në ankimin e saj si më poshtë.

56.1. Analiza financiare e kryer nga Komisioni për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për blerjen në vitin 2012, të truallit me sip. 360 m², është e gabuar, si pasojë e konstatimeve të pasakta nga Komisioni të likuiditeteve në bankë dhe përlllogaritjes së gabuar të shpenzimeve të jetesës. Subjekti parashtrroi se si pasojë e korigjimit të pasaktësive të pretenduara më sipër, viti 2012 rezultoi me një bilanc negativ, në vlerën prej 181.274 lekësh, e cila sipas subjektit është vlerë e vogël dhe, për rrjedhojë, Kolegji duhet ta vlerësojë këtë rezultat në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

56.2. Konkluzioni i Komisionit për ndërtim të paligjshëm duke iu referuar këtu investimit të kryer për ndërtimin në vitin 2013 në tokën me sip. 360 m² në {***}, të një godine dykatëshe me sip. totale ndërtimi 200 m², dhe të legalizuar në vitin 2018, është i pabazuar. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti pretendoi se (i) fillimi i punimeve për kryerjen e këtij ndërtimi është iniciuar nga vetë ligji nr. 141/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar që lejon legalizimin e ndërtimeve në tokën e vet, për rrjedhojë subjekti pretendon se “ka zbatuar dhe përfituar nga benefitet e ligjit”; (ii) ndërtesa tashmë rezultoi e legalizuar dhe, për rrjedhojë, përdorimi nga ana e Komisionit i terminologjisë “ndërtim i paligjshëm” është i pajustificuar dhe i qëllimshëm për të rënduar pozitën e subjektit të rivlerësimit.

56.3. Konkluzioni i Komisionit lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të investitorit, z. N. M., në vlerën e 5.281 eurove, për ndërtimin e godinës 2-katëshe dhe mobilimin

e saj, është i pabazuar në fakte dhe joobjektiv, pasojë e përcaktimit të gabuar nga ana e Komisionit, e vlerës së shpenzimeve të jetesës për z. M. dhe familjen e tij.

57. Në parashtrimet e saj të paraqitura në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit, ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit për kualifikimin e z. N. M. si *person tjetër i lidhur*, si konkluzion të gabuar dhe në keqinterpretim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016.
58. Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për rezultat të gabuar të analizës financiare të kryer nga Komisioni në kuadër të kontrollit të burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për blerjen e tokës në vitin 2012, trupi gjykues vëren si më poshtë.
59. Sa i takon çështjes së përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim këtë zë shpenzimesh në analizën e Komisionit dhe e krahasoi atë me të dhënat e INSTAT-it, konstatoi se Komisioni ka pasqyruar në tabelë një vlerë shpenzimesh jetese prej 697.740 lekësh, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit pretendon se shpenzimet e saj sipas INSTAT-it, duhet të jenë në vlerën e 546.480 lekëve. Nga verifikimi i kryer në të dhënat e INSTAT-it, shpenzimi i pretenduar nga subjekti u referohet të dhënave të Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës të vitit 2012, për një familje me 4 persona. Ndërsa vlera e këtij shpenzimi, e përlllogaritur nga ana e Komisionit, konstatohet të jetë më e madhe se shpenzimi vjetor për një familje me 4 persona dhe pothuajse në vlerën e shpenzimit vjetor për një familje me 5 persona (705.120 lekë), referuar të njëjtimit anketim.
60. Në vlerësim të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar qëndrimin e Komisionit në lidhje me përlllogaritjet e shpenzimeve të jetesës në nivelin e 697.740 lekëve, duke mbajtur parasysh që, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit të Komisionit të datës 15.05.2019¹⁹, nëna e bashkëshortit të subjektit ka filluar të jetojë me familjen e tyre në vitin 2012, duke e shndërruar atë në një familje me 5 anëtarë.
61. Sa u takon pretendimeve lidhur me pasqyrimin jo të saktë nga ana e Komisionit në analizën financiare të likuiditeteve bankare, Kolegji, pasi kreu verifikimet e gjendjes së likuiditeteve bankare për vitin 2012 të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, konstatoi se përlllogaritjet e Komisionit lidhur me likuiditetet bankare ishin pasqyruar në tabelën e analizës financiare në mënyrë të saktë. Sa i takon pretendimit të subjektit në parashtrësit e tij para Kolegjit, se në analizën financiare të Komisionit për vitin 2012, nuk është marrë në konsideratë gjendja *cash* e likuiditeteve që janë tërhequr nga banka më 28 maj 2012 (dy muaj përpara blerjes), në vlerën e 500.000 lekëve dhe të cilat, sipas subjektit, janë përdorur pikërisht për blerjen e tokës, truell në {***}, më 25.07.2012, me vlerë 881.280 lekë, trupi gjykues, pasi kreu verifikimet e nevojshme nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, arriti në përfundimin se ky pretendim nuk bazohet në fakte. Ky transaksion i kryer nga subjekti i rivlerësimit në datën 28.05.2012, rezultoi të jetë përfshirë në përlllogaritjet e Komisionit në formën e ndryshimit të likuiditetit në llogari bankare (gjendje likuiditetesh më datë 31.12.2012 – gjendjen e likuiditeteve më datë 01.01.2012). Në rast të kundërt, ndryshimi i likuiditeteve do të rezultonte me vlerë më të lartë, të shtuar me aq sa është vlera e tërhequr. Kjo vlerë likuiditeti e tërhequr në datën 28.05.2012, në përlllogaritjet e kryera, ndryshe

¹⁹ Në përgjigjet e pyetësorit të protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 15.05.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Vjehrra ime, H. B. S., për periudhën 2003-2012, në fakt ka jetuar me djalin e saj I. S. në Tiranë dhe se për këtë periudhë nuk kam pasur çfarë të deklaroj. Ajo është kthyer në Shkodër tek ne në vitin 2012, e në qershor të vitit 2013 ka ndërruar jetë duke u varrosur në Shkodër”.

nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, është vlerësuar për mbulimin e shpenzimeve totale të kryera gjatë atij viti për krijimin e pasurisë tokë truall dhe shpenzimet e tjera familjare, përderisa nuk u arrit të provohet nga subjekti i rivlerësimit se ky likuiditet prej 500.000 lekësh është përdorur ekskluzivisht për blerjen e pasurisë tokë truall.

62. Sa u takon pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj, në parashtrimet e saj para Kolegjit, lidhur me përlllogaritjet e kryera nga Komisioni të shpenzimeve të udhëttimeve me destinacion Malin e Zi, me efekt ndër të tjera edhe në analizën e këtij viti financiar, trupi gjykues, pasi verifikoi nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor mënyrën e përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve, konstatoi se ato nuk janë llogaritur në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga Kolegji në vendimin e tij nr. 11, datë 22.05.2019. Rezultoi që Komisioni për udhëtimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, vajtje-ardhje brenda ditës me destinacionin e sipërpërmendur, ka përlllogaritur shpenzime udhëtimi në vlerë më të ulët (20 euro dita/person) se sa parashikuar sipas metodologjisë së Kolegjit (50 euro dita/person), me arsyetimin që në këto raste ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se shpenzimet e udhëttimeve janë përlllogaritur nga Komisioni në mënyrë të gabuar, jo në përputhje me metodologjinë e sipërpërmendur, duke sjellë si pasojë shpenzime më të larta udhëtimi, u gjet i pabazuar në fakte. Trupi gjykues evidenton se pretendimi për mosalokim shpenzimesh udhëtimi në rastin e udhëttimeve pranë të afërmeve familjarë dhe ngarkimin e subjektit vetëm me sasinë e të hollave të xhepit, 5 euro dita/person, duhet të provohet me dokumentacion justifikues i cili të tregojë se shpenzimet e këtyre udhëttimeve janë mbuluar prej tyre. Për rrjedhojë, sa kohë ky pretendim mbeti në nivel deklarativ, nuk u mor në konsideratë nga ana e trupit gjykues.
63. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me pasaktësitë në përlllogaritje nga ana e Komisionit, nuk janë të bazuara në fakte dhe, si rrjedhojë, rezultati i kësaj analize për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme në shumën prej 680.089 lekësh, për të krijuar pasurinë “tokë truall” me sip. 360 m², në {***}, {***}, me vlerë 881.280 lekë dhe konkluzioni përfundimtar i Komisionit se për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e saj në përputhje me nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, gjenden të drejtë dhe të bazuar në fakte dhe në ligj.
64. Në kuadër të analizës së pretendimeve të ngritura nga ana e subjektit të rivlerësimit sipas paragrafit 56.2 në vendim, në drejtim të kundërshtimit të përfundimit të arritur nga Komisioni se godina e ngritur mbi truallin me sipërfaqe 360 m², në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj është ndërtim i paligjshëm, trupi gjykues vlerësoi fillimisht të evidentojë faktin që arsyetimi i Komisionit lidhur me këtë çështje fokusohet në drejtim të konstatimit të faktit të kryerjes së një veprimi në kundërshtim me ligjin, i cili rëndon pozitën e subjektit të rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit dhe jo vetëm, pavarësisht se Komisioni nuk i ka atribuar pasojë juridike këtij fakti, në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se tashmë ky ndërtim është një ndërtim i legalizuar dhe se përdorimi i terminologjisë “ndërtim i paligjshëm” nga ana e Komisionit është i pajustificuar dhe i qëllimshëm për të rënduar pozitën e subjektit të rivlerësimit, vlerësohet nga ana e trupit gjykues si pretendim i pabazuar, vlerësuar në kontekstin e trajtimit që i ka bërë kësaj çështjeje Komisioni në vendimin e tij.
65. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se fillimi i punimeve për kryerjen e këtij ndërtimi është iniciuar nga vetë ligji nr. 141/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të

ndryshuar” i cili sipas subjektit të rivlerësimit lejonte ndërtimet në tokën e vet, trupi gjykues, pasi mori në analizë legjislationin e kohës lidhur me çështjen e legalizimit të ndërtimeve pa leje, vëren si më poshtë.

- Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, në nenin 2, pika 1 e tij parashikonte se dispozitat e këtij ligji zbatoheshin për të gjitha objektet e ndërtuara pa leje, të ngritura para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, pavarësisht nëse ato kanë funksion strehimi, veprimtarie ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore etj.
- Me ligjin nr. 141/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, të ndryshuar (referuar edhe nga subjekti i rivlerësimit në ankim), legjislatori miratoi shtesën e një paragrafi të ri pas pikës 1 të nenit 2 të ligjit bazë si më sipër cituar, me përmbajtje si vijon: *Në ndryshim nga kushti i përcaktuar në paragrafin e parë të kësaj pike, ky ligj mund të zbatohet për objektet e ndërtuara pa leje, të ngritura pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit, vetëm në rast se për to procedura e legalizimit nuk kërkon kalim pronësie mbi truallin.*
- Në të njëjtin ligj ndryshues u miratua edhe dispozita kalimtare (neni 45/1), me përmbajtje si më poshtë:
 1. *Për ndërtimet pa leje të ngritura pas vitit 2006, ALUIZNI merr masa nëpërmjet evidentimit faktik të situatës ndërtimore në terren, si dhe fotografimit ajror digjital apo përdorimit të imazhit satelitor të konvertuar në fotografi ajrore, të korrektuar gjeometrikisht (ortofoto). Rregullat e hollësishme për këtë qëllim përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, me miratimin e ministrit që mbulon procesin e legalizimeve.*
 2. *Subjektet, që posedojnë ndërtime pa leje/shtesa informale në objekte me leje, të ngritura pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, duhet të paraqesin pranë drejtorive të ALUIZNI-t, brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kërkesë për legalizim, sipas formularit tip të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t.*

66. Në analizë të legjislationit të kohës si më sipër cituar, trupi gjykues konstaton se ndryshimet ligjore në ligjin bazë për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, të miratuara me ligjin nr. 141/2013, i cili rezulton të ketë hyrë në fuqi më datë 05.06.2013, lejonin legalizimin e ndërtimeve pa leje të kryera në truallin në pronësi, edhe në rastin kur këto ndërtime ishin kryer pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit bazë për legalizimin (ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006), të cilat deri në miratimin e këtij ndryshimi ligjor nuk mund të kualifikoheshin si objekte për legalizim për shkak të mosplotësimit të kriterit të kohës së ndërtimit të tyre para datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006. Terminologjia e përdorur në paragrafin e shtuar pas pikës 1 të nenit 2 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “të ngritura pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit”, u referohet ndërtimeve të kryera pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 dhe jo datës së hyrjes në fuqi të ligjit ndryshues nr. 141/2013, siç duket se pretendon subjekti i rivlerësimit. Kjo për faktin se parashikimi i ri ligjor lexohet dhe interpretohet në kontekstin e nenit 2 të ligjit bazë dhe i referohet parashikimit mbi kriterin përjashtues kohor të kryerjes së ndërtimeve pa leje, sipas pikës 1 të të njëjtit nen. Sa më sipër, konfirmohet edhe nga parashikimet e regjimit tranzitor sipas nenit 45.1 të ligjit nr. 141/2013, ku për të gjitha ndërtimet ekzistuese pa leje, të ngritura pas vitit 2006, ALUIZNI duhet të merrte masat për evidentimin faktik të situatës ndërtimore në terren, ndërkohë që të gjitha subjektet që posedonin ndërtime pa leje, të ngritura pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, duhet të paraqisnin pranë drejtorive të ALUIZNI-t, brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kërkesën për legalizim.

67. Në kuadër të sa më sipër analizuar, trupi gjykues arrin në përfundimin se parashikimet e ligjit ndryshues nr. 141/2013, kurrsesi nuk parashikonin, lejonin apo favorizonin kryerjen e ndërtimeve në kundërshtim me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi, vetëm sepse ndërtimi kryhej në truallin në pronësi. Një interpretim i tillë i parashikimeve të ligjit nr. 141/2013 është i papranueshëm, për sa kohë zbatimi i dispozitave të tij do të krijonte përplasje me norma të tjera ligjore në fuqi dhe me karakter detyrues në fushën e ndërtimeve. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit në ankim, sipas së cilit: *Ligji nr. 141/2013 që ka ndryshuar ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", ka hyrë në fuqi më dt. 05.06.2013, aplikimi nga E.S. është i datës 17.07.2013, që përkon me gjendjen karabina të ndërtesës, e se periudha 2-mujore është e mjaftueshme për ngritjen e karabinasë. Kjo tregon se fillimi i punimeve është iniciuar nga vetë ligji nr. 141/2013 (që lejon legalizimin e ndërtimeve në tokë të vet) duke mundësuar të aplikojmë për legalizim (pra kam zbatuar dhe përfituar nga benefitet e ligjit) – vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar në ligj dhe rrjedhojë e një keqinterpretimi, me qëllim justifikimin e faktit të kryerjes së një ndërtimi në shkelje të legjislacionit të zbatueshëm. Këtë veprim (ndërtimin e paligjshëm), ndryshe nga sa arsyeton në mënyrë të gabuar Komisioni – ndërtimet e paligjshme nga dhjetori i vitit 2014, parashikohen si vepër penale referuar nenit 199/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë – legjislatori e ka parashikuar si vepër penale që në vitin 2009, kur me ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, shtoi në Kodin Penal një nen të ri 199/a, me përmbajtje: 1. Ndërtimi i paligjshëm i një objekti në tokën e vet dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. 2. Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.*
68. Trupi gjykues çmon se edhe në rastin eventual të kryerjes së ndërtimit nga ana e investitorit, kryerja e aplikimit pranë ALUIZNI-t nga ana e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për legalizim të objektit pa leje, që në fazë të hershme të ndërtimit, atë të karabinasë, provon më së paku dijeninë e këtij të fundit për moszbatimin e legjislacionit në fuqi për ndërtimet (moskërkimin/marrjen e lejes së ndërtimit) dhe pranimin e këtij fakti. Për më tepër që referuar parashikimeve të aktmarrëveshjes me nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 31.12.2012, në prani të noteres L. H., palët (pronarët e truallit dhe investitorët në ndërtim) kishin rënë dakord që me marrjen e lejes, palët do të hartonin kontratën përfundimtare ku do të saktësonin sipërfaqet e ndërtimit që i takonin pronarit, bazuar mbi projektin e miratuar, çka konfirmon edhe një herë se pronarët e truallit ishin në dijeni të plotë që nuk ishte nxjerrë asnjë leje ndërtimi dhe se objekti po ndërtohej në shkelje të legjislacionit përkatës.
69. Sa i takon ndërtesës 2-katëshe të ngritur mbi pasurinë tokë truall me sip. 360 m², të blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2012, në kuadër të kontrollit të vendimmarrjes së Komisionit dhe vlerësimit të saj sipas shkaqeve të ankimit, në përputhje dhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjtit në drejtim të konceptit të personit tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe pasojave ligjore që i atribuohen subjektit në rast mospërmbushjeje të detyrimit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive që janë rrjedhojë e kësaj lidhjeje interesi pasuror, trupi gjykues konstaton si më poshtë.
- 69.1.** Vendimmarrja e Komisionit lidhur me krijimin e pasurisë së paluajtshme si më sipër cituar, sipas së cilës subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm të saj, pasi nuk ka mundur ta justifikojë atë, në përputhje me germën "b" të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, arsyetohet se ka ardhur si rrjedhojë e dështimit të subjektit të rivlerësimit për të provuar me dokumentacion se investitori, z. N. M., ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për ndërtimin e godinës 2-katëshe, si dhe për mobilim.

69.2. Arsytimi i Komisionit në vendimin e tij rreth kësaj pasurie, edhe pse nuk u është referuar në mënyrë të shprehur parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, është orientuar rreth kësaj dispozite dhe detyrimit që ajo përcakton për subjektin e rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur me të për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të pasurive të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e interesit e lindur mes tyre.

70. Në këtë kontekst, trupi gjykues, pas verifikimit të akteve të fashikullit të Komisionit lidhur me krijimin e kësaj pasurie, konstatoi se marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit të saj dhe dy familjarëve të tjerë të këtij të fundit, znj. M. M. (motra e z. E. S.) dhe z. N. M. (djali i motrës së z. S.) në raport me ndërtesën 2-katëshe të ndërtuar në vitin 2013 dhe të legalizuar në vitin 2018, është krijuar mbi bazën e akteve vijuese.

70.1. Aktmarrëveshjes “Pronarë truallit investitorë” me nr. rep {***}, nr. kol. {***}, datë 31.12.2012, të lidhur në prani të noteres L. H., mes subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj në cilësinë e pronarëve të truallit dhe znj. M. M. në cilësinë e investitore. Sipas kësaj marrëveshjeje: *Pronarët e truallit Valbona dhe E. S. venë në dispozicion të palës investuese, përfaqësuar nga M. M., një truall me sipërfaqe 360 metra katrorë që ndodhet në fshatin {***} [...] me qëllim që të bëhet një ndërtim, shtëpi banimi dykatëshe, sipas lejes së ndërtimit që do të jepet nga Komuna {***} Shkodër. Investitorja sipërmarrëse do të bëjë ndërtimin e godinës mbi truallin në fjalë me mjetet e saj financiare (të ardhura nga djali) i saj N. M. i cili jeton në Itali dhe se me ardhjen e tij nga Italia në Shqipëri do të rikonfirmohet marrëveshja edhe në prezencë të tij. [...] Palët bien dakord që në përfundim të objektit, pronarët e truallit do të marrin 50% të sipërfaqes së ndërtimit, e ndarë kjo sipas kateve në plan vertikal dhe horizontal. [...] pala pronare e truallit Valbona dhe E. S. nuk do të ketë asnjë lloj shpenzimi për ndërtimin e kësaj banese, përveç sipërfaqes së truallit prej 360 metrash katrorë të vënë tërësisht në dispozicion, pasi i gjithë ndërtimi do të përballohet nga investitore M. M., e financuar nga djali i saj N. M., i cili jeton në Itali. Marrëveshja do të rikonfirmohet pas përfundimit të ndërtimit në vitin 2014 dhe në prezencë të djalit të saj.*

70.2. Deklaratës mbi rikonfirmimin e aktmarrëveshjes “Pronarë truallit investitorë” me nr. rep. {***}, nr. {***} kol., datë 15.08.2014, në prani të noteres L. H. Sipas kësaj deklarate noteriale, z. N. M. deklaroi: *Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se nëna ime M. M., me cilësinë e investitore në truallin pronë e znj. Valbona Seknaj dhe E. S. me sipërfaqe 360 metra katrorë, që ndodhet në fshatin {***}, Velipojë [...] ka marrë përsipër ndërtimin e një shtëpie banimi dykatëshe sipas lejes së ndërtimit që do të jepet nga Komuna {***}, ndërtim i cili do të bëhet me të ardhurat e mia. Këtë aktmarrëveshje, sot, më datë 15.08.2014, e rikonfirmoj dhe deklaroj se jam plotësisht dakord me të gjitha pikat e saj.*

71. Nga shqyrtimi i këtyre akteve, në vlerësim të trupit gjykues, provohet ekzistenca e lidhjes së interesit që kanë pasur mes tyre subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nga njëra anë me znj. M. M. dhe z. N. M. nga ana tjetër, në kuptim të përkufizimit të dhënë në nenin 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, si pasojë e marrëveshjes së investimit e cila konsiston në shkëmbimin e pronësisë mbi një pjesë të tokës truall me 50% të sipërfaqes ndërtimore të objektit që do të ndërtohet me shpenzimet e palës investitore në truallin në pronësi të subjektit të rivlerësimit, sipas aktmarrëveshjes noteriale të sipërcituar. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues konstaton se marrëdhënia e interesit pasuror mes personave të sipërcituar nuk përfshihet në mënyrë të shprehur në gamën e marrëdhënieve të përcaktuara shprehimisht në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni, për më tepër, nuk ka arsyetuar në drejtim të faktit nëse kjo marrëdhënie mund apo jo të kualifikohej ligjërisht si marrëdhënie interesi e cila u nënshtrohet parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pavarësisht se rezultojnë që në konkluzionin e tij për këtë pasuri, i ka

atribuuar subjektit të rivlerësimit pasojat e mospërmbushjes së detyrimit të përcaktuar nga kjo dispozitë. Në përfundim të sa më sipër, në harmoni të plotë edhe me qëndrimet e deritanishme të Kolegjit në vendimmarrje të mëparshme në drejtim të interpretimit të konceptit të *personit tjetër të lidhur* sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se konkluzioni i Komisionit, se *subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, në përputhje me nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, si pasojë e të mosprovuarit me dokumentacion se investitori N. M ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për ndërtimin e godinës 2-katëshe dhe mobilimin e saj*, është konkluzion i pabazuar në ligj, për sa kohë marrëdhënia mes subjektit të rivlerësimit dhe investitorit nuk përmbush kriteret ligjore për t’u përfshirë në gamën e marrëdhënieve të përcaktuara shprehimisht në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që të mund të kualifikohet z. N. M si *person tjetër i lidhur* me subjektin e rivlerësimit në kuptim të kësaj dispozite ligjore.

72. Pavarësisht sa më sipër, në vlerësimin në tërësi të kësaj pasurie të paluajtshme e cila është ndërtuar në kuadër të një marrëveshjeje investimi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj me znj. M. M. dhe z. N.M, për shkëmbim të pasurisë tokë truall me sipërfaqe ndërtimore të objektit të ndërtuar mbi këtë sipërfaqe tokë, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se mungesa e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të blerë truallin mbi të cilin është ngritur godina 2-katëshe në fjalë cenon ligjshmërinë e investimit të kryer mbi këtë sipërfaqe toke, në drejtim të origjinës së pasurisë së krijuar sipas marrëveshjes së investimit.
73. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, bazuar në analizën e mësipërme faktike dhe ligjore arriti në këto konkluzione:
- (i) Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durraj), ka kryer deklaram të pasaktë të pasurive në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi nuk ka deklaruar burimet e krijimit të pasurive në pronësi të saj dhe të personave të lidhur me të, në përputhje me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
 - (ii) Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të E. S. kanë kryer deklaram të pasaktë të të ardhurave të krijuara, përkatësisht nga ushtrimi i profesionit të avokatit dhe aktiviteti privat i tregtisë së artikujve ushqimorë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
 - (iii) Për pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 115,3 m², në adresën: rr. “{***}”, Tiranë, me vlerë 78.000 euro, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të E. S. rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
 - (iv) Për pasurinë e paluajtshme të llojit “dyqan” me sip. 46 m² në Shkodër, blerë në vitin 1997, me vlerë 30.000 USD dhe pjesën e pandarë të dyqanit me sip. 10 m², blerë në vitin 2006, me vlerë 500.000 lekë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të E. S. rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
 - (v) Për pasurinë e paluajtshme të llojit “tokë truall”, me sip. 360 m², në fshatin {***}, {***}, Shkodër, blerë në vitin 2012, me vlerë 881.280 lekë, mbi të cilën është ndërtuar një godinë 2-katëshe, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të E. S. rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
74. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 33, pika 5, germat “a” dhe “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 175, datë 04.07.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrnjaj).

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 14.07.2021, në Tiranë.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi